

Hyrjet në Toskanë

Për të gjithë personat të cilët do të hyjnë në Toskanë, ose kanë hyrë gjatë 14 ditëve të fundit, me përjashtim të atyre për të cilët lëvizjet janë të justifikuara për arsye pune ose situata të domozdoshme ose arsye shëndetësore, mbasi kanë qëndruar në zonat me rrezik epidemiologjik, siç janë identifikuar nga Organizata Botërore e Shëndetit, ose në rajonet dhe provincat e tjera, të identifikuar nga masat përkatëse nacionale, është e detyrueshme që banorët ose personat me vendbanim fiks (rezidentë) në Toskanë duhet të procedojnë me vet izolimin vullnetarë nga dita e fundit të ekspozimit, duke komunikuar këtë situatë, mbi të gjitha në prani të simptomave, mjekut ose pediatrit të tyre të familjes, ose kontakteve të mëposhtme të vëna në dispozicion nga Qëndrat shëndetësore:

Asl Toscana qendrore (Firenze, Prato, Pistoia, Empoli)
tel. 055.5454777 email rientrocina@uslcentro.toscana.it

Asl Toscana veri perëndim (Pisa, Livorno, Lucca, Massa Carrara, Viareggio)
tel. 050.954444 email rientrocina@uslnordovest.toscana.it

Asl Toscana jug lindje (Arezzo, Grosseto, Siena)
tel. 800.579579 - 800.050529 email rientrocina@uslsudest.toscana.it

Kush, për arsye të ndryshme nga ato të punës, situatave të domozdoshme ose arsyeve shëndetsore, vjen në Toskanë, ose ka ardhur gjatë 14 ditëve të fundit, mbasi ka qëndruar në zonat me rrezik epidemiologjik, duke mos pasur në territorin e Toskanës mjekun ose pediatrin e tyre të familjes, të kthehen në shtëpinë e tyre, në banesën ose (rezidencën) përndryshe të procedojnë me izolimin vullnetarë duke ia komunikuar kontakteve të mësipërme.

Nëse subjektet e lartpërmendura i drejtohen një urgjence të Shërbimit Sanitarë të Toskanës, në mungesë të një gjendje shëndetsore gjatë cilës është e nevojshme shtrimi në spital, do të dërgohen të merren në ngarkim nga Mjeku ose Pedatri në vendbanimin e tyre jasht Toskanës, ku ata duhet të shkojnë.